

SHPALLJE POZICIONI VAKANT

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë me të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukture dhe menaxhim projektësh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet me të larta ndërkombetare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qendrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Ekonomist Magazine në objekt ndërtimor

❖ DETYRAT KRYESORE

- Proceson të gjitha hyrjet dhe daljet e artikujve në magazine në përputhje me rregullat dhe procedurat e kompanisë dhe konform dokumentacionit përkatës;
- Siguron që magazina të perdoret ekskluzivisht për ruajtjen e inventarit, me akses të kufizuar;
- Ben verifikimet përkatëse të mallrave për cilesinë dhe sasinë së bashku me dokumentacionin respektiv;
- Ben etiketimin e artikujve në përputhje me procedurat e kompanisë;
- Ben regjistrimin e Flete-Hyrjeve dhe Flete-Daljeve në mënyrë kronologjike në Sistemin Financiar..
- Ben të mundur që standardet e sigurisë zbatohen për ruajtjen e inventareve, duke marrë në konsideratë kërkesat teknike dhe teknologjike të materialeve;
- Asiston në procesin e Nxjerrjes Jashtë Përdorimit dhe perditeson regjistrat e inventarit dhe kartelat e artikujve përkatës që aprovohen për të dalë jashtë përdorimit;
- Asiston në procesin e inventarit fizik të magazinave duke i vënë në dispozicion komisionit të gjithë informacionin dhe facilitetet e nevojshme;
- Merr masa për të siguruar ruajtje të sigurt të artikujve, duke përfshirë masat kundër humbjes apo vjedhjes;
- Dorezon në mënyrë periodike informacionin Përgjegjës të Magazines;
- Raporton për mallrat e demtuara dhe mallrat me qarkullim të ngadalshëm.

❖ KRITERET KRYESORE

Edukimi: Ekonomik, Administrim Biznesi

Gjuhë të huaja: Anglisht, – nivel mesatar

Njohuri kompjuterike: Paketa Office, njohuri në programe financiare. Preferohet njohja e sistemit Financa 5 ose Alpha.

Eksperiencia e kërkuar: Mbi 3 vjet eksperiencë në pozicion të ngjashëm. Preferohet eksperiencë në kompani ndërtimi.

Të gjithë të interesuarit, janë të lutur që të dergojnë CV nëpërmjet adresës së e-mailit careers@gener2.al ose të plotësojnë formularin e aplikimit në faqen zyrtare www.gener2.al në seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit është **data 10 Shtator 2023, ora 17:00**.

* Vetëm kandidatet e perzgjedhur do të kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrotjen e të dhënave personale”.